



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 14, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 3077 Prot., datë 29.05.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në lidhje me periudhën për të cilën kërkon informacion, organizimi dhe funksionimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ishte i ndryshëm nga KLD e krijuar me Kushtetutën e vitit 1998 dhe ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001, në të cilin përcaktohej se organizimi i mbledhjeve plenare në ato vite, zhvillohej në institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë apo dhe në Ministrinë e Drejtësisë, institucione këto të cilat përgatisnin dokumentacionin që shqyrtohej në të, për rrjedhojë dhe procesverbalet me vendimet përkatëse.

Regjistrat e protokollit të ish- Këshillit të Lartë të Drejtësisë, fillojnë nga viti 2003, kohë në të cilën është krijuar kjo zyrë protokolli, dhe njëkohësisht ka filluar funksionimin Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me miratimin e ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 9 e vitit 2002), bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk disponon procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, pasi dokumentacioni i kërkuar, nuk është i krijuar nga institucioni i Këshillit të Lartë të Drejtësisë që u trashëgua, dhe aq më pak nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!